

DEKLARATA POLITIKE

INICIATIVA QYTETARE SHQIPTARE për Graçanicën ka për qëllim unifikimin e faktorit politik shqiptar si dhe shoqërisë civile në Komunën e Graçanicës. Kjo Iniciativë do të shërbejë si bashkim i ideve për të mirën e qytetarëve shqiptar të kësaj komune, si dhe të bëhet pjesë e proceseve të rëndësishme në legjislativ dhe vendimmarrje të Komunës së Graçanicës.

Kjo iniciativë do të përkujdeset dhe angazhohet për mbrojtjen e interesave dhe vlerave të shqiptarëve, duke qenë kështu shtylla kryesore për përfaqësim të denjë në nivelin lokal. Po ashtu Iniciativa do të shtrihet brenda gjithë territorit të Komunës së Graçanicës me qëllimin e vetëm që shqiptarët të jenë pjesë e kësaj iniciative dhe që të shërbejë për nevojat dhe të drejtat e tyre.

INICIATIVA SHQIPTARE do të jetë zëri i unifikuar i shqiptarëve në këtë komunë dhe do të angazhohet fuqishëm edhe në ri-organizim në çdo sferë. Ndër prioritetet tjera do të jenë edhe, arsimi, shëndetësia, kultura, bujqësia dhe sporti.

Me këtë rast INICIATIVA SHQIPTARE për Graçanicën përveç partive politike shqiptare në këtë komunë do të jete e hapur edhe për të gjithë qytetarët shqiptar pa dallim, për të kontribuar në përfaqësim që deri më tani mungonte. Iniciativa do të përkujdeset për t'iu dhënë përparësi rinisë dhe intelektualve shqiptar, si dhe gjinisë femërore nga ku do të vihet baza kryesore e këtij organizimi për përfaqësim dinjitoz.

J.A. et'